

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-208/13

Prishtinë,
3 Qershor 2015

Në çështjen juridike të:

Komuna e Podujevës

Podujevë

Pala ankuese

Përfaqësues: Xh. R., avokat

Podujevë

kundër

R. R. I.

Serbi

Palë përgjegjëse në ankesë

dhe kundër

Klubi i Futbollit B.

Podujevë

Palë përgjegjëse në ankesë/PPA2

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tej: KKPK) nr. KPCC/D/A/187/2013 të datës 13 shkurt 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin. KPA38107), në tekstin e mëtejme po ashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 3 Qershor 2015, mori këtë

AKTGJYKIM:

- 1. Hedhet poshtë ankesa e Komunës së Podujevës kundër Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/187/2013, të datës 13 shkurt 2013, sa i përket kërkesës nr. KPA38107, si e paafatshme.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 29 tetor 2007, R. R. R., pala përgjegjëse në ankesë, ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij pronësore mbi një ngastër toke në Livadicko Polje, Komuna e Podujevës, zona kadastrale Livadicë, numër 235, (në tekstin e mëtejme: pronë e kërkuar).
2. Prona u verifikua pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-së më 2 qershor 2010.
3. Më 10 gusht 2012, Komuna e Podujevës nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes dhe iu drejtua AKP-së si palë përgjegjëse në kërkesë (PPK1). Kërkesa u kontestua po ashtu nga ekipi futbollistik B., i përfaqësuar nga avokati, Xh. R. (PPA2). Palët përgjegjëse në kërkesë morën pjesë në procedurën para KKPK-së.
4. KKPK-ja vendosi në Vendimin e KKPK-së se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ishte pronar i 1/1 së pronës së kërkuar, se ai ka të drejtë legjitime në atë pronë dhe se palët përgjegjëse në kërkesë duhej ta lironin pronën.
5. Vendimi iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 19 qershor 2013 dhe palës ankuese dhe palës tjetër përgjegjëse në ankesë (PPA2) më 13 qershor 2013. Së bashku me vendimin është dhënë edhe një fletë njoftuese mbi ankesat.

6. Pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 12 korrik 2013. AKP vulosi datën 19 korrik 2013 si datën e pranimit të ankesës në letrën e ankesës. Ankesa iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 12 nëntor 2013.
7. Asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën e apelit para Gjykatës Supreme.
8. Gjykata Supreme ia dërgoi AKP-së një urdhër gjyqësor për të qartësuar se në çfarë mënyre kishte arritur letra e ankesës në AKP: me postë apo e dërguar në ndonjë mënyrë tjetër. Nëse është pranuar me postë, nga AKP-ja është kërkuar që ta dorëzojë zarfin të cilin e ka pranuar me qëllim që të shihet se në cilën datë pala ankuese e ka dërguar letrën e ankesës në zyrën postare.
9. Në përgjigjen e saj ndaj urdhrit, të datës 11 nëntor 2014, AKP-ja është përgjigjur si në vijim. Kur pala dërgon një ankesë apo dokument tjetër përmes shërbimit të Postës, zarfi gjithnjë mbahet në shkresat e lëndës. Nëse pala dorëzon një letër personalisht me zarf në zyrat e AKP-së, zarfi nuk mbahet. Në atë rast dhe po ashtu kur letra dorëzohet pa zarf, në dokument vulolet data e pranimit. Në këtë rast, letra e ankesës nuk ka arritur në AKP përmes postës. Duket se në këtë rast, letra ka mbërritur nëpërmjet një personi i cili letrën e ankesës e kishte vendosur në një zarf të mbyllur dhe zyrtari i AKP-së në recepsion e kishte pranuar zarfin, kishte vënë vulën mbi të dhe zyrtari përgjegjës në zyrën e AKP-së e kishte hapur zarfin, e kishte vënë vulën në letër dhe e kishte regjistruar letrën e ankesës sipas datës së vulës në zarf.
10. Kjo përgjigje e AKP-së i është dorëzuar palës ankuese.
11. Gjykata Supreme po ashtu ia ka dërguar palës ankuese një urdhër gjyqësor që të argumentojë, së bashku me prova, se ankesa nuk është e paafatshme. Urdhri i gjykatës po ashtu përmbante pyetje rreth meritave të lëndës.
12. Pala ankuese është përgjigjur në pyetjen lidhur me pranueshmërinë e ankesës si në vijim. Vendimi i KKPK-së ishte dorëzuar në zyrën e Drejtorit të Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë së komunës në periudhën kur Drejtori ishte në pushim vjetor dhe askush nga stafi i komunës nuk kishte qasje në zyrën e tij. Me rastin e hapjes së letrave të dorëzuara nga drejtori i cili erdhi në zyre për një rast urgjent, vendimi ishte dorëzuar tek përfaqësuesi i komunës për mosmarrëveshje ligjore dhe pastaj përfaqësuesi i autorizuar dorëzoi menjëherë një ankesë me datën 12 korrik 2013 dhe më 15 korrik 2013 ajo ishte adresuar tek AKP. Me këtë përgjigje është dorëzuar një vendim mbi lejimin e pushimit vjetor për A. Ll., Drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, për

periudhën nga 28 qershori 2013 deri më 18 korrik 2013. Më tutje pala ankuese deklaroi se raporti mbi dorëzimin e letrave tek PTK-ja është dorëzuar së bashku me këtë përgjigje, mirëpo Gjykata Supreme nuk e ka gjetur këtë raport.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

13. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerçiale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji/UNMIK 2006/50) brenda 30 ditësh nga njoftimi i palëve për vendimin e KKPK-së mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë.
14. Pala ankuese e ka pranuar vendimin e KKPK-së më 13 qershor 2013. Afati prej 30 ditësh për të paraqitur ankesë ka përfunduar të shtunën më 13 korrik 2013 dhe prandaj është zgjatuar deri në ditën e punës në vijim që ka qenë të hënën më 15 korrik 2013.
15. Sikurse rrjedh nga faktet dhe përgjigja e AKP-së të cekur më herët në paragrafët 5 dhe 8, letra e ankesës është pranuar të premtën më 19 korrik 2013. Pala ankuese nuk e ka kundërshtuar këtë informatë të AKP-së.
16. Pala ankuese nuk ka siguruar prova se më 12 korrik 2013, data në letrën e ankesës, ose me datën 15 korrik 2013 të kishte dërguar letrën e ankesës tek AKP-ja.
17. Fakti se Drejtori i Drejtorisë Komunale të Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë ishte në pushim kur është dërguar vendimi i KKPK-së tek pala ankuese nuk është shkak i justifikueshëm për ankesë të vonuar. Vendimi i KKPK-së ishte paraqitur më 13 qershor 2013. Kështu që, pala ankuese kishte mundësinë të dorëzojë ankesën me kohë.
18. Nga këto fakte rrjedh se pala ankuese (përfaqësuesi i saj) e ka paraqitur ankesën pas afatit të fundit prej 30 ditësh. Prandaj, ankesa është e papranueshme sepse është paafatshme.

Konkludim

19. Rrjedhimisht, sipas nenit 13.3 të Ligjit UNMIK 2006/50, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

20. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit UNMIK 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it